

RAPORTI I RREGULLT EKONOMIK PËR  
**BALLKANIN PERËNDIMOR** nr. 24 | Vjeshtë 2023.

# Drejt rritjes së qëndrueshme

**KOSOVË**



## Kosovë

- Përballë një ambienti të jashtëm sfidues, rritja reale e BPV-së është ngadalësuar por mbetet pozitive; aktiviteti ekonomik pritet të zgjerohet me 3,2 për qind gjatë vitit 2023.
- Performanca pozitive e eksportit të shërbimeve dhe konsumit privat ishin shtytësit kryesor të rritjes.
- Inflacioni është në rënie krahasuar me kulmin prej 14,2 për qind të arritur në korrik 2022, por presioni mbi çmimet mbetet i lartë; inflacioni vjetor i çmimeve të konsumit pothuajse arriti mesataren prej 6 për qind në mes të janarit dhe gushtit 2023.
- Ndonëse parashikimi mbetet pozitiv, rreziqet për ngadalësim janë domethënëse, përfshirë këtu: pasiguritë e vazhdueshme lidhur me luftën në Ukrainë, një ngadalësimi i mëtejshëm i aktivitetit ekonomik në Evropë, dhe kompleksiteti i vazhdueshëm i ambientit politik.

### Zhvillimet e fundit ekonomike

**Parametrat makroekonomik të Kosovës mbetën të favorshëm gjatë gjysmës së parë të vitit 2023, përkundër paqëndrueshmërisë së vazhdueshme nga jashtë dhe ngadalësimit të rritjes në tremujorin e dytë të vitit.** Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023, aktiviteti real ekonomik u zgjerua me 2 për qind vit më vit<sup>1</sup>, duke e çuar rritjen në 2,9 për qind për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023. Rritja gjatë tremujorit të dytë u nxit kryesisht nga rritja reale e eksporteve prej 5,9 për qind, nxitur nga rritje rekorde e eksportit të shërbimeve (13,6 për qind); kryesisht për shërbimet e udhëtimit që lidhen me diasporën dhe shërbimet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK). Eksportet e mallrave, ndryshe nga pritjet fillestare, u tkurrën me 10,7 për qind në terma real. Konsumi privat dhe bruto formimi i kapitalit panë një rritje të moderuar prej 3,7 dhe 2 për qind, respektivisht. Nga ana e prodhimit, shërbimet dhanë kontributin më të lartë në rritje. Treguesit mujorë, përfshirë këtu për sektorin e jashtëm, qarkullimin e ndërmarrjeve, dhe fluksin e udhëtimeve ndërkombëtare, dëshmojnë se

ndikimi i konsumit dhe eksportit të shërbimeve në rritje ishte i fortë përgjatë tre tremujorëve të parë të vitit.

**Inflacioni është në rënie të vazhdueshme prej normës maksimale prej 14,2 për qind të arritur në korrik 2022, por presioni mbi çmimet mbetet i lartë.** Inflacioni i çmimeve të konsumit arriti një mesatare prej 6 për qind në mes të janarit dhe gushtit 2023; norma mujore e inflacionit u ngadalësua vazhdimisht, duke zbritur në 2,4 për qind në korrik 2023, por pati mëpastaj një rritje të lehtë në gusht 2023 (3,2 për qind). Gjatë kësaj periudhe, rritja e çmimeve të orendive, artikujve shtëpiak dhe mirëmbajtjes (7,2 për qind), pijeve alkoolike dhe duhanit (6,3 për qind) dhe ushqimeve dhe pijeve joalkoolike (5,5 për qind) ishin shtytësit kryesor të inflacionit. Çmimet e transportit—që në vitin 2022 i dhanë nxitjen më të lartë inflacionit—patën efekt të kundërt, duke e ngadalësuar inflacionin (-3.8 për qind). Me 4 për qind në gusht, inflacioni bazë u rrit, dhe vazhdon të mbetet më i lartë se sa inflacioni i përgjithshëm. Çmimet e importeve vazhduan të rriten, por me një prirje të ngadalësimit, të ndikuara kryesisht nga rënia e çmimeve të

1 Të gjitha referencat nga këtu e tutje i referohen krahasimeve nga viti në vit, përveç nëse tregohet ndryshe.

mallrave dhe importit të energjisë. Nga ana tjetër, si çmimet e inputeve prodhuese ashtu edhe ato bujqësore pësuan rënie në krahasim me gjysmën e parë të vitit 2022.

**Punësimi dhe formalizimi i punësimit janë në rritje, por tregu i punës vazhdon të përballet me sfida kritike.** Sipas të dhënave të fundit administrative, punësimi formal u rrit me 2,8 për qind në mes të gushtit 2022 dhe gushtit 2023<sup>2</sup>. Anketa më e fundit e Fuqisë Punëtore (AFP)<sup>3</sup> zbuloi se popullsia në moshë pune u tkurr gjatë vitit 2022, me gjasë për shkak të migrimit, ndërsa raporti i punësimit ndaj popullsisë në moshë pune përjetoj rritje, nga 31,1 për qind në vitin 2021 në 33,8 për qind në vitin 2022. Duhet theksuar se shkalla e papunësisë mbetet në trajektore rënëse, duke arritur në 12,6 për qind në vitin 2022, por kjo kundrejt normave të joaktivitetit që ende mbeten të larta. Të dhënat e AFP edhe më tej nxjerrin në pah pabarazitë e shquara gjinore brenda tregut të punës, duke përfshirë dallime të konsiderueshme në normat e punësimit (49,4 për qind për meshkujt dhe 18,4 për qind për femrat në vitin 2022), normat e joaktivitetit (45 për qind për meshkujt dhe 78 për qind për femrat), si dhe nivelet e moderuara të papunësisë së të rinjve (21,4 për qind). Kosova nuk ka statistika zyrtare për vendet e lira të punës, por anketat individuale nga shoqatat e biznesit tregojnë sfida gjithnjë e më të mëdha për plotësimin e vendeve të lira të punës, veçanërisht për punonjësit e kualifikuar.

**Deri në qershor 2023, deficitin i llogarisë rrjedhëse (DLLRR) tregoi shenja përmirësimi, të nxitura nga rënia e vlerës së importeve, shoqëruar me një performancë**

**të vazhdueshme pozitive nga eksporti i shërbimeve dhe fluksi i të ardhurave dytësore.** Eksportet dhe importet nominale të mallrave ranë me 8,1 dhe 5,2 për qind, respektivisht. Bilanci tregtar i shërbimeve u rrit me 36 për qind deri në qershor 2023. Prandaj, deficitin tregtar ra me 1,8 për qind gjatë kësaj periudhe. Në të njëjtën kohë, remitencat regjistruan një rritje kumulative prej 11,7 për qind. Investimet e huaja direkte (IHD) vazhduan të kenë një performancë pozitive me rritje kumulative prej 14,3 për qind deri në qershor 2023. Megjithatë, IHD mbeten shumë të përqendruara në sektorin e ndërtimit dhe pronës së paluajtshme, duke pasqyruar kërkesën e diasporës kosovare për patundshmëri në Kosovë.

**Bilanci i përgjithshëm fiskal mbeti brenda kufijve të pëcaktuar me rregullat fiskale.** Për periudhën janar-gusht 2023, dhe në përputhje me sezonalitetin e shpenzimeve buxhetore, qeveria pati suficit, pak mbi nivelin e regjistruar më 2022. Për të njëjtën periudhë, të ardhurat nga tatimet u rritën me 12 për qind, ndërsa të ardhurat e përgjithshme u rritën me 15 për qind, të plotësuara gjithashtu nga grante buxhetore të BE-së për energjinë, me vlerë prej 67,5 milionë euro. Tatimet direkte dhe TVSH-ja e mbledhur brenda vendit u rritën me gati 20 për qind, ndërsa TVSH-ja dhe akcizat e mbledhura në kufi (që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e të hyrave tatimore) u rritën me rreth 6 për qind, secila. Shpenzimet, nga ana tjetër, u rritën me 16,2 për qind deri në gusht 2023. Implementimi i legjislacionit të ri për pagat në sektorin publik ka çuar në rritje prej 20 për qind të faturës mujore të pagave. Duke pasur parasysh ndërprerjen e subvencioneve për importin e energjisë, dhe një rënie të numrit

2 Statistikat Administrative të Tregut të Punës, gusht 2023, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

3 Kosova ka vonesa të mëdha në publikimin e të dhënave të anketës së fuqisë punëtore (AFP) dhe që sot janë të disponueshme vetëm të dhënat e vitit 2022.

të përfituesve për disa skema të pensioneve dhe programin e ndihmës sociale, shpenzimet totale për subvencionet dhe transfertat pësuan rënie të lehtë, me 1 për qind. Në korrik 2023, Kuvendi amandamentoj legjislacionin për skemat pensionale me financim nga shteti, çka pritet të rrisë përfitimet mesatare nga këto skema; por, edhe barra fiskale e këtij ndyrshimi në të ardhmen me shumë gjasë do jetë domethënëse. Shpenzimet kapitale u rritën me 77 për qind deri në gusht 2023, ndonëse nga një bazë relativisht e ulët e vitit 2022. Pavarësisht nga rritja e ndjeshme e shpenzimeve, implementimi i projekteve kapitale me financim të jashtëm vazhdon të çalojë. Deri në fundvit, implementimi i subvencioneve shtesë lidhur për energjinë dhe pagesat më të larta për projektet kapitale në fundvit pritet të çojnë në deficit fiskal modest—por pak më të lartë se ai i vitit të mëparshëm.

**Që nga janari 2023, borxhi publik dhe ai i garantuar publikisht (PPG) ka qenë në trend rënës.** Deri në fund të tremujorit të dytë të këtij viti, borxhi PPG ishte 17,3 për qind e BPV-së, nga 19,9 për qind e BPV-së në fund të vitit 2022. Në vitin 2023, Qeveria amortizoi më shumë se 120 milionë euro borxh të brendshëm. Nga ana tjetër, borxhi i jashtëm vazhdoi të rritej me një ritëm të moderuar, por me më pak se gjysmën e nivelit të reduktimit të stokut të borxhit të brendshëm. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2023, Qeveria arriti me FMN-në një marrëveshje për financim në rast nevoje ‘Stand-By’ (rreth 100 milionë Euro) dhe një marrëveshje për instrumentin e reziliencës dhe qëndrueshmërisë (rreth 78 milionë euro). Deri në shtator të vitit 2023, ende nuk janë tërhequr mejte në kuadër të këtyre dy programeve. Së fundmi, Qeveria vendosi të fillojë shpërgimin e tërheqjeve individuale prej fondit të kursimeve pensionale të autorizuar në vitin 2020 si

pjesë e masave për mbështetje të likuiditetit në kontekst të pandemisë.

**Rritja e kostos së huamarrjes nuk e uli kërkesën për kredi.** Deri në korrik 2023, kreditë e përgjithshme bankare u rritën me 13,2 për qind (8,3 për qind për kreditë e reja), ku totali i kredive për ekonomitë shtëpiake u rrit me 16,9 për qind. Portofoli i kredisë për mikrofinancë—i cili përfaqëson më pak se 10 për qind të portofolit të kredisë bankare, por ofron shërbime për një numër të konsiderueshëm të qytetarëve—u rrit me gati 24 për qind. Në të njëjtën kohë, depozitat u rritën me 13,2 për qind. Kostoja e financimit u rrit mesatarisht me 0,6 pike përqindjeje në periudhën janar-gusht 2023 në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2022. Normat mesatare të interesit për kreditë e reja, si shembull, u rritën nga 5,9 në 6,5 për qind. Rezervat e kapitalit dhe cilësia e aseteve mbeten pozitive. Raporti i kapitalit rregullator mbi asetet e peshuara nga rreziku ishte 15,6 për qind në gusht 2023 dhe kreditë joperformuese mbetën në 2 për qind të total kredive.

## **Perspektiva dhe Rreziqet**

**Përkundër presioneve të vazhdueshme inflacionare, rritja reale e BPV-së pritet të arrijë në 3,2 për qind përgjatë 2023, mbështetur në performancën pozitive të eksportit dhe konsumit më të lartë privat.** Eksportet më të larta të shërbimeve pritet të kompensojnë uljen e eksporteve të mallrave dhe rritjen e importeve, duke çuar në kontribut pozitiv nga ngushtimi i bilancit tregtar në rritjen e BPV-së. Në të njëjtën kohë, rritja e fortë e kredisë dhe remitencave neto, mbështetur edhe nga nivele më të larta të transfertave publike, pritet ta mbështesin konsumin

privat. Shpenzimet më të larta të pagave publike pas implementimit të Ligjit të ri për pagat, të shoqëruara me rritjen e shpenzimeve publike për mirëmbajtje dhe shërbime, pritet të mbështesin rritjen e konsumit publik. Po ashtu, pas kontraktimit në vitin 2022, bruto investimet fikse pritet ta shtojë rritjen, të nxitura nga aktiviteti i ndërtimit dhe një mjedis më i parashikueshëm për çmimet e materialeve bazë. Shpenzimet kapitale publike pritet gjithashtu të nxisin investimet pas përpjekjeve të fundit për t'i hequr pengesat në implementim, duke përfshirë edhe azhurnimin e çmimeve në punët publike. Nga ana e prodhimit, shërbimet sërish pritet të japin një kontribut më të lartë sesa prodhimi dhe bujqësia së bashku.

**Perspektiva afatmesme mbetet pozitive, brenda një konteksti të pasigurisë së lartë.**

Kontributi i investimeve në rritje pritet të rritet në vitet 2024–2025, i mbështetur nga rritja e investimeve në infrastrukturën publike, duke përfshirë me mbështetjen e financimit të jashtëm dhe investimeve më të larta publike dhe private në furnizim dhe efikasitet të energjisë. Megjithatë, pavarësisht përmirësimeve të pritura në ekzekutimin e shpenzimeve kapitale, investimet publike pritet të mbeten nën nivelet e buxhetuara. Bazuar në regjistrat e lejeve të ndërtimit, ndërtimtaria pritet të vazhdojë nxitjen e investimeve dhe të rritjes në afat të mesëm. Thellimi financiar dhe fluksi i të ardhurave primare dhe sekondare [nga jashtë] pritet ta mbështesin konsumin, shoqëruar me transfere më të larta publike si rezultat i rritjes së faturës së pensioneve në vitin 2024. Riaktivizimi i kapaciteteve prodhuese të ferronikelit nga Kosova pritet t'i rrisë eksportet e mallrave. Ritja pritet të përshpejtohet drejt 4 për qind, duke bërë që niveli i aktivitetit ekonomik të ulë hendekun me atë që konsiderohet nivel i tanishëm potencial për Kosovën. Megjithatë,

pasiguritë e vazhdueshme lidhur me luftën në Ukrainë dhe ndikimi i mundshëm i tyre në sektorin e energjisë në Kosovë, ngadalësimi i mëtejshëm i aktivitetit ekonomik në Evropë dhe përkeqësimi i kontekstit politik vendas përbëjnë rreziqe të rëndësishme.

**Inflacioni pritet të ngadalësohet, por presionet e çmimeve mbeten të larta.**

Ndërsa mbetet në rënie krahasuar me trendet ndërkombëtare, inflacioni i çmimeve të konsumit parashikohet të arrijë në 4,8 për qind në vitin 2023 dhe të ngadalësohet më tej gjatë viteve 2024–2025, duke pasqyruar pritjet mbi inflacionin e Euro-zonës dhe lëvizjet ndërkombëtare të çmimeve të mallrave. Megjithatë, një treg më i ngushtë i punës mund të ushtrojë presion më të madh mbi inflacionin. Në të njëjtën kohë, varësia e lartë e Kosovës nga importet vazhdon ta ekspozojë vendin ndaj luhatjeve ndërkombëtare të çmimeve. Çmimet më të larta të karburantit dhe të energjisë mund të çojnë në rritje të inflacionit dhe tronditje të furnizimit me energji, duke ndikuar negativisht në rritje.

**Pas përkeqësimit të ndjeshëm gjatë viteve 2020–2022, DLLRR pritet të përmirësohet në periudhë afatmesme.**

Në vitin 2023, DLLRR pritet të përmirësohet për 4 pp. të BPV-së për shkak të ngadalësimit të importeve dhe përmirësimeve të mëtejshme në bilancin e shërbimeve. Gjatë viteve 2024–25, DLLRR pritet të bjerë më tej për shkak të përmirësimeve në bilancin tregtar, ndonëse me ritëm më të ngadaltë. Fluksitet hyrës të IHD, që nuk krijonë borxhe, pritet të vazhdojnë të jenë burimi kryesor i financimit për DLLRR, por nivelet e larta të gabimeve dhe harresave në bilancin e pagesave mbeten një burim i pasigurisë. Mbikonzentrimi i IHD-së në veprimtaritë që lidhen me patundshmerinë pritet të vazhdojë në

afat të mesëm, por investimi privat më i lartë në sektorin e energjisë mund të çojë potencialisht në diversifikimin më të lartë të IHD-së.

**Deficiti fiskal vlerësohet të mbetet nën 1 për qind të BPV-së në vitin 2023, i nxitur nga performanca pozitive e të ardhurave tatimore dhe nën-ekzekutimi i shpenzimeve kapitale.**

Por, në periudhë afatmesme, niveli i deficitit pritet të ngritet në një mesatare prej 1,5–2 për qind të BPV-së kundrejt rritjes së shpenzimeve kapitale të lidhura me Strategjinë e Energjisë, rritjes së mëtejshme të koeficientëve të pagave publike dhe operacionalizimit të shtesave në paga përgjatë 2024, si shpenzimeve më të larta për pensione. Të hyrat nga tatimet pritet të vazhdojnë të rriten, megjithëse me një normë më të ngadalë se në periudhën 2021–2023 duke pasur parasysh ndikimin në zbehje të inflacionit, veçanërisht në tatimet që vilen në kufi. Implementimi i ndryshimeve të vitit 2023 në legjislacionin për tatimin mbi të ardhurat personale që barazon kufirin e pa-tatueshëm me nivelin e ri të pagës minimale, aktualisht në pritje të shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese, mund ta ngadalësojë ritmin e mbledhjes së të hyrave. Deri në vitin 2025, borxhi publik parashikohet të mbetet nën 20 për qind të BPV-së, duke pasur parasysh trendin në implementimin e projekteve kapitale të financuara nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare (IFN).

**Thellimi i mëtejshëm financiar ka potencialin për ta mbështetur rritjen e kredive, konsumin privat dhe investimin në periudhë afatmesme.** Ndryshimet ligjore të parashikuara në legjislacionin e pagesave mund ta nxisin më tej digitalizimin e pagesave, duke përmirësuar gjithashtu formalizimin. Borxhi i jashtëm


privat, i cili përfshinë kreditë me kompanitë amë dhe kredinë tregtare, pritet gjithashtu të jetë në rritje.

**Në vitet në vijim, Kosova duhet ta përmirësojë qëndrueshmërinë e saj ndaj tronditjeve të jashtme, dhe të zbatojë reforma strukturore që zhblokjnë një rritje më të lartë potenciale dhe përshpejtojnë konvergencën me vendet e krahasueshme të BE-së.** Që nga shpërthimi i pandemisë COVID-19, menaxhimi i matur makro-fiskal i ka mundësuar Kosovës t'u përgjigjet ndikimeve të krizës. Megjithatë, mbyllja e hendekut me vendet e krahasueshme të BE-së do të kërkojë ruajtjen e stabilitetit makroekonomik duke trajtuar njëkohësisht pengesat strukturore afatgjate që e kufizojnë potencialin për prodhim.

Implementimi efektiv dhe me kohë i Strategjisë së re të Energjisë, duke mbarëvajtur stabilitetin fiskal, është qenësor në këtë drejtim. E njëjtë është edhe nevoja për t'i adresuar nevojat infrastrukturore në sektorin e ujit, mbeturinave dhe transportit. Përmirësimi i rezultateve të tregut të punës nuk mund të presë më, dhe duhet të fokusohet në mbështetjen e përfshirjes më të madhe të grave joaktive në tregun e punës, duke adresuar pengesat për pjesëmarrjen e tyre në këtë treg dhe duke rritur qasjen në shërbimet e përkujdesit për fëmijët. Për më tepër, zgjerimi i investimeve të kapitalit njerëzor, si parakusht për ta zhbllokuar rritjen më të lartë potenciale duke ruajtur stabilitetin fiskal kërkon reforma efektive dhe gjithëpërfshirëse në: a) optimizimin e rrjetit të shkollave b) zhvillimin e një kornize të financimit të shëndetësisë që nxitë ofrim universal të shërbimeve shëndetësore; c) përmirësimin e shënjestritimit të ndihmës sociale dhe parashikueshmërisë dhe pëshatshmërisë së nivelit të pensioneve.

## Investimet u rikthyen, duke dhënë një kontribut modest, por pozitiv në rritje në vitin 2023.


Kontributet në rritje, pikë përqindjeje



Burimet: Agjencia e Statistikave të Kosovës; kalkulimet e stafit të Bankës Botërore.

## Deficiti fiskal mbetet i moderuar.


Në përqindje të PBB-së



Burimet: Ministria e Financave; kalkulimet e stafit të Bankës Botërore.

## Punësimi me trend gradualisht në rritje.


Punësimi total sipas AFP, në mijëra



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës.

## Eksportet e shërbimeve vazhduan të rriten, të nxitura nga udhëtimet, por edhe TIK dhe shërbimet e biznesit.


Eksportet e shërbimit sipas kategorisë, në miliona Euro



Burimet: Banka Qendrore e Kosovës.

## Presionet e inflacionit nisën të lehtësohen në vitin 2023.


Ndryshimet nga viti në vit, për qind



Burimi: Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe Banka Qendrore e Kosovës.

## Sektori financiar mbeti i qëndrueshëm.

Treguesit kryesorë të shëndetit financiar, në përqindje



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës.

Shënim: fip = fundi i periudhës; KJP = kredi joperformuese.

<b>KOSOVË</b> Treguesit e përzgjedhur ekonomikë	2020	2021	2022	2023e	2024f	2025f
Britja e PBB-së reale (në përqindje)	-5,3	10,7	5,2	3,2	3,9	4,0
<i>Përbërja (pikë përqindjeje):</i>						
Konsumi	2,1	8,2	3,9	2,3	3,4	3,4
Investimet	-2,8	5,0	-1,2	0,4	1,3	1,3
Eksportet neto	-4,7	-2,4	2,6	0,5	-0,8	-0,7
Eksportet	-8,3	16,4	6,4	3,8	2,2	2,3
Importet (-)	-3,6	18,8	3,9	3,3	3,1	3,0
Inflacioni i çmimit të konsumatorit (për qind, mesatarja e periudhës)	0,2	3,4	11,6	4,8	3,0	2,5
Të hyrat publike (në përqindje të PBB-së)	25,4	27,4	27,8	28,7	28,2	28,3
Shpenzimet publike (në përqindje të PBB-së)	33,0	28,8	28,2	29,2	30,1	30,1
<i>Prej të cilit:</i>						
Shpenzime për paga (në përqindje të PBB-së)	9,8	8,4	7,3	7,9	7,5	7,5
Asistencë sociale (në përqindje të PBB-së)	7,7	7,3	7,2	6,4	6,5	6,2
Shpenzime kapitale (në përqindje të PBB-së)	5,6	5,3	4,7	5,6	6,3	6,8
Bilanci fiskal (në përqindje të PBB-së)	-7,6	-1,3	-0,4	-0,6	-1,9	-1,9
Bilanci primar fiskal (në përqindje të PBB-së)	-7,2	-0,9	0,0	-0,2	-1,6	-1,3
Borxhi publik (në përqindje të PBB-së)	22,0	21,2	19,6	18,5	19,3	19,8
Borxhi publik dhe i garantuar publik (në përqindje të PBB-së)	22,4	21,6	19,9	18,6	19,5	20,1
<i>Prej të cilit: I jashtëm (në përqindje të PBB-së)</i>						
Eksportet e mallrave (në përqindje të PBB-së)	7,0	9,5	10,4	8,8	9,0	9,2
Importet e mallrave (në përqindje të PBB-së)	45,0	54,3	58,4	54,5	53,6	53,7
Eksportet neto të shërbimeve (në përqindje të PBB-së)	5,8	13,0	15,4	16,6	16,3	16,8
Bilanci tregtar (në përqindje të PBB-së)	-32,2	-31,8	-32,6	-29,1	-28,3	-27,7
Prurjet neto nga remitencat (në përqindje të PBB-së)	14,0	14,1	13,3	13,7	13,6	13,5
Bilanci i llogarisë rrjedhëse (në përqindje të PBB-së)	-7,0	-8,7	-10,5	-6,5	-6,0	-5,5
Flukset hyrëse neto të investimeve të huaja direkte (në përqindje të PBB-së)	4,2	4,0	6,7	6,7	6,7	6,7
Borxhi i jashtëm (në përqindje të PBB-së)	36,9	37,6	38,2	38,4	39,0	39,9
Britja reale e kreditimit privat (në përqindje, mesatarja e periudhës)	7,6	7,5	5,2	-	-	-
Kreditë jo-performuese (në përqindje të totalit të kredive, fundi i periudhës)	2,5	2,3	2,0	-	-	-
Norma e papunësisë (në përqindje, mesatarja e periudhës)	25,9	20,7	12,6	-	-	-
Norma e papunësisë së të rinjve (në përqindje, mesatarja e periudhës)	49,1	38,0	21,4	-	-	-
Norma e pjesëmarrjes në forcën e punës (në përqindje, mesatarja e periudhës)	38,3	39,3	38,6	-	-	-
PBB për kokë banori (\$)	4 321	5 270	5 305	5 810	5 804	6 758
Norma e varfërisë (për qind e popullsisë)	32,4	27,0	25,4	23,6	22,2	20,3

*Shënim:* Kalkulimet e normës së varfërisë bazuar në harmonizimin ECAPOV duke i përdorur të dhënat e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF). Vlerat e transmetuara/të parashikuara fillojnë në vitin 2018. Masat e të ardhurave në SILC dhe masat e konsumit në ABEF nuk janë rreptësisht të krahasueshme. Varfëria përkufizohet si jetesë me më pak se 6,85 dollarë amerikanë/ditë për person në PPP të rishikuar 2017. e=vlerësim; f = parashikimi; PPP = pariteti i fuqisë blerëse. - = nuk është në dispozicion.







Raporti i Rregullt Ekonomik për  
**Ballkanin Perëndimor** nr. 24 | Vjeshtë 2023

---

Shikoni raportin online:  
[www.worldbank.org/eca/wbrer](http://www.worldbank.org/eca/wbrer)